



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AGJENCIA E PROKURIMIT PUBLIK
DREJTORIA JURIDIKE DHE E MONITORIMIT TË PROCEDURAVE

Nr. 6758 Prot.

Tiranë, më 05.10 2022

VENDIM

Nr. 03 Datë 05.10 2022

**PËR
MIRATIMIN E DISA NDRYSHIMEVE NË DOKUMENTET STANDARDE TË
TENDERIT PËR MALLRA, PUNË, SHËRBIME PËR PROCEDURËN E
PROKURIMIT "E KUFIZUAR"**

Në mbështetje të shkronjës "c", të nenit 23 të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 "Për prokurimin publik", të pikës 2, dhe pikës 1, të nenit 14 të Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", të ndryshuar, Agjencia e Prokurimit Publik (në vijim "APP")

Vendos:

Në Dokumentet Standarde të Tenderit (në vijim "DST"), për mallra, punë, shërbime, për procedurën e prokurimit "E Kufizuar" të miratuara me Vendimin e APP Nr. 6, datë 23.06.2021, bëhen këto ndryshime:

1. Në çdo set DST për mallra, punë, shërbime, ndryshohet "*Njoftimi i Kontratës*", sipas formatit bashkëlidhur këtij vendimi, i cili bëhet pjesë e seteve respektive.
2. Në çdo set DST për mallra, punë, shërbime, ndryshohet "*Formulari Përmbledhës i Vetëdeklarimit*", sipas formatit bashkëlidhur këtij vendimi, i cili bëhet pjesë e seteve respektive.
3. Në çdo set DST për mallra, punë, shërbime, ndryshohen "*Njoftimi i Fituesit (Paraparak)*" dhe "*Njoftimi i Fituesit (në përfundim të afateve të ankimit)*" sipas formatit bashkëlidhur këtij vendimi, të cilët bëhen pjesë e seteve respektive.
4. Në çdo set DST për mallra, punë, shërbime, ndryshohen "*Formulari i Njoftimit të Operatorëve Ekonomikë të suksesshëm në Marrëveshjen Kuadër (Paraparak)*" dhe "*Formulari i Njoftimit të Operatorëve Ekonomikë të suksesshëm në Marrëveshjen Kuadër (në përfundim të afateve të ankimit)*", sipas formatit bashkëlidhur këtij vendimi, të cilët bëhen pjesë e seteve respektive.

5. Ngarkohen autoritetet/entet kontraktore për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim publikohet në faqen zyrtare të APP dhe hyn në fuqi në datë 17. 10.2022.

DREJTOR I PËRGJITHSHËM

Reida Kashta

